



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.118/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Malishevë, për shkak të vendosjes së materialeve zgjedhore në hapësirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 08.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dhe Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Malishevë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,050.00 (*tremij e pesëdhjetë*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 06 qershor 2017, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017 në sheshin e “Dëshmorëve”, në rrugën “Avdyl Krasniqi” në Malishevë, aktivisti Bekim Gashi ka vërejtur se në hapësirë publike është vendosur një bilbord i kandidatëve për deputetë nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e Koalicionit PDK-AAK-NISMA është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b i Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbën veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në përgjigjen në ankesë i datës 07.06.2017, Koalicioni PDK-AAK-NISMA theksojnë se pas pranimit Urdhërit për Përmirësim nga ana e PZAP-it, kanë urdhëruar degën në Malishevë që të ndërmerre veprime përmirësuese me çka është evituar shkelja. Më tutje thekson se, koalicioni PDK-AAK-NISMA vendosjen bilbordit të kandidat për deputet të Kuvendit të Kosovës nga radhët e koalicionit në fjalë, në parkun e qytetit në rrugën “Avdyl Krasniqi” në Malishevë, janë vendosur gabimisht dhe pa qëllim, pra ky veprim është bërë nga aktivistët tanë, prandaj ka shprehur keqardhje për shkeljen e ligjit dhe rregullave zgjedhore të fushatës. Koalicioni PDK-AAK-NISMAi ka vendosur bilbordat e kandidatëve për deputet nga radhë e saj, të vendosura në vendin e pa lejuar, mirëpo PZAP-in e ka njoftuar përmes përgjigjes në ankesë se i ka ndërmarrë veprimet e duhura për evitimin e shkeljes së pretenduar sipas parashtruesit të ankesës .

Lidhur me veprimet e ndërmarra përgjigjes në ankesë iu ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenin 117 paragrafi 2 i LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se billbordi i kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA është vendosur në hapësira publike-në qendër veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e theksuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që billbordi i kandidatëve për deputet nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA është vendosur në rrugë.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe e njëjta shkelje është përsëritur disa herë gjatë këtij procesi zgjedhor nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, ngase materiali zgjedhor si billbordi i kandidatit për deputet nga radhët e koalicionit në fjalë, është vendosur në hapësirë publike-qendër të qytetit, veprim ky që është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Po ashtu, paneli me rastin e vendosjes mori parasysh përpjekjet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA për të përmirësuar shkeljet duke i larguar posterët nga vendi ku ishin të vendosur, pasi që paneli e kishte urdhëruar koalicionin në fjalë që të largon billbordin nga vendi ku ishte i ndaluar pra vendosja e të njëjtit. Veprimet të cilat paneli i mori parasysh gjatë vendimmarrjes e që ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, dhe në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) i LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.118/2017 më datën 08.06.2017



Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.